MINISTRIA E DREJTËSISË
Nr. 2631/5 Prot.
Datë 19.07.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM

Nr. 434, datë 15.7.2021

PËR

PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE SI DHE TË RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 77, të ligjit nr.79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim përcakton kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (këtu e në vijim "Komisioni"), si dhe rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e tij.

KREU II
ORGANIZIMI I KOMISIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Neni 2
Përbërja dhe mandati i anëtarëve

1. Komisioni ka në përbërje 9 (nëntë) anëtarë, si më poshtë vijon:

   a) Një anëtar i caktuar nga Presidenti i Republikës;
   b) Një anëtar i caktuar nga Kryetari i Kuvendit;

c) Një anëtar i caktuar nga Kryeministri;
ç) Një anëtar i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm;
d) Një anëtar i caktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin;
dh) Një anëtar i caktuar nga ministria përgjegjës për financat;
e) Një anëtar i caktuar nga ministria përgjegjës për shëndetësinë;
ë) Një anëtar i caktuar nga ministria përgjegjës për drejtësinë;
f) Një anëtar i caktuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë.

2. Anëtarët e Komisionit qëndrojnë në detyrë për 4 (katër) vjet, pa të drejtë ricaktimi.

Neni 3
Kriteret për caktimin e anëtarëve

Organet e emërtesës, sipas përcaktimit të nenit 2, të këtij vendimi, caktojnë anëtarë shtetasit që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale si dhe kriteret e mëposhtme:

a) Të jenë shtetas shqiptarë;
b) Të zotërojnë diplomë të ciklit të dytë, të studimeve të larta në drejtësi ose shkenca sociale ose diplomë të barasvlefshme me to;
c) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
ç) Të mos kenë qenë dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
d) Të kenë një profil të spikatur dhe eksperiencë profesionale në fushën e drejtësisë, të drejtave të njeriut ose sistemin e burgjeve;
dh) Në kohën e caktimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të legjislacionit në fuqi për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, si dhe të afërm të shkallës së parë që janë punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ose në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
e) Të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptim të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;
ë) Të mos jenë bashkëpunëtorë, informatorë ose agjentë të shërbimeve të inteligjencës.

Neni 4
Zhvillimi i mbledhjeve dhe mbështetja administrative

1. Komisioni ngrihet pranë ministrit të Drejtësisë dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë vendin.

2. Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet strukturave të saj ose Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas parashikimeve të këtij vendimi, siguron mbështetjen e nevojshme organizative, administrative dhe financiare për realizimin e funksionit dhe të detyrave të Komisionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale dhe në këtë vendim.

Neni 5
Zgjedhja e kryetarit dhe e zëvendëskryetarit

1. Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit zgjidhen me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, për një periudhë 2-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje.

2. Mbledhja për zgjedhjen e kryetarit drejtohet nga anëtari më i vjetër në moshë.

3. Anëtarët e Komisionit shprehin interesin për t'u zgjedhur si kryetar apo zëvendëskryetar në mbledhjen e parë. Drejtuesi i mbledhjes garanton kohë të mjaftueshme dhe të barabartë për prezantimin e anëtarëve që kanë shprehur interesin.

4. Në rast se ka më shumë se një kandidat dhe gjatë votimit asnjëri prej tyre nuk merr shumicën e parashikuar të votave, bëhet një votim i ri dhe, pas këtij, vijohet me votimin mes kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në përfundim të këtij votimi shpallet i zgjedhur kandidati që ka marrë shumicën e votave. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave ose votat janë ndarë në mënyrë të barabartë, kryetari caktohet me short.

5. Kryetari i zgjedhur njofton ministrin e Drejtësisë.

Neni 6
Detyrimi i pjesëmarrjes në mbledhje dhe konflikti i interesave

1. Pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit në mbledhjet dhe veprimtaritë e tij është e detyrueshme përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të kësaj detyre.

2. Anëtari i Komisionit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten ose për një anëtar tjetër të Komisionit lidhur me një çështje të caktuar, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose të pengesës, të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse dhe në votimin e saj.

3. Anëtarët e Komisionit që janë në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore nuk marrin pjesë në mbledhje por, në çdo

rast, njoftojnë menjëherë me shkrim kryetarin për pengesën ligjore për pjesëmarrjen në mbledhje.

Neni 7
Shpërblimi i anëtarëve të Komisionit

1. Anëtarët e Komisionit ushtrojnë veprimtarinë e tyre kundrejt shpërblimit. Masa e shpërblimit për kryetarin dhe anëtarët përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve.

2. Shpenzimet për kryerjen e pagesës së anëtarëve të Komisionit, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, si dhe çdo shpenzim tjetër i natyrës operative (jo shpërblim), të kryer për realizimin e detyrave të organeve kolegjiale, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.

KREU III
FUNKSIONIMI DHE VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Neni 8
Funksionet dhe veprimtaria e Komisionit

1. Komisioni ushtron kompetencat që i janë ngarkuar nga ligji në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale dhe veçanërisht kompetencat e mëposhtme:

   a) Kryen verifikime, edhe pa paralajmërim, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
   b) Kontakton me të burgosur të veçantë apo kryen takime me ta;
   c) Kryen këqyrje të dokumentacionit dhe të mjediseve të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale;
   ç) Shqyrton dhe verifikon ankesa ose njoftime;
   d) Kryen çdo verifikim tjetër të nevojshëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale lidhur me respektimin e të drejtave të të dënuarve, kushtet e trajtimit dhe zbatimin e ligjit;
   dh) Komunikon me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Shërbimin e Provës, prokurorinë dhe gjykatat;
   e) Koordinon veprimtarinë e tij me Avokatin e Popullit dhe shkëmben informacione në funksion të garantimit të të drejtave në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale;
   ë) Informon ministrin e Drejtësisë kur konstaton shkelje apo problematika në lidhje me funksionimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale;

f) Kryen çdo verifikim tjetër në përmbushje të trajtimit të ankesës ose njoftimeve të paraqitura;
g) Shqyrton dhe miraton masat e veprimet lidhur me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Komisionit me organe shtetërore, institucione ndërkombëtare, si edhe organizata të tjera me objekt veprimtarie ose ekspertizë në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe ekzekutimit të vendimeve penale;
gj) Shqyrton dhe miraton masat e nevojshme për mirorganizimin e mbledhjeve dhe të veprimtarive të Komisionit;
j) Krijon grupe pune për të përgatitur rekomandime, programe apo materiale të nevojshme për garantimin e përmbushjes së funksionit dhe kompetencave të Komisionit.

2. Mbledhja e Komisionit ushtron edhe çdo kompetencë tjetër të nevojshme për organizimin dhe funksionimin e tij.

Neni 9
Kryetari

1. Kryetari i Komisionit ushtron këto funksione:

a) Përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e Komisionit;
b) Përfaqëson Komisionin në marrëdhëniet me të tretët;
c) Siguron mbështetjen administrative, organizative dhe financiare të Ministrisë së Drejtësisë për funksionimin e Komisionit;
ç) Harton dhe bën publik në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë raportin vjetor mbi veprimtarinë e Komisionit, me leje të ministrit të Drejtësisë;
d) Siguron dokumentimin e mbledhjes se Komisionit dhe mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat;
dh) Nënshkruan vendimet dhe çdo akt tjetër që lidhet me ushtrimin e kompetencave të Komisionit dhe shkresat e ndryshme për komunikimin e Komisionit me të tretët;
e) Ushtron çdo detyrë tjetër të përcaktuar në këtë vendim si dhe nga mbledhja e Komisionit.

2. Në pamundësi objektive a pengesë ligjore të kryetarit, këto funksione ushtrohen nga zëvendëskryetari i Komisionit.

Neni 10
Përgatitja e mbledhjeve të Komisionit

1. Përcaktimi i çështjeve të rendit të ditës dhe caktimi i ditës së zhvillimit të mbledhjes së Komisionit bëhet nga kryetari, duke mbajtur parasysh mendimin e anëtarëve. Në rendin e ditës përfshihen edhe çështjet që mund të propozohen, me shkrim nga secili prej anëtarëve të tjerë të Komisionit. Nëse dita e mbledhjes së Komisionit është paracaktuar në mbledhjen paraardhëse,

njoftimi i anëtarit për çështje që duhet të përfshihen në rendin e ditës duhet të paraqitet jo më vonë se 3 (tre) ditë nga ajo e caktuar për zhvillimin e mbledhjes.

2. Për përgatitjen e çështjeve të rendit të ditës dhe të dokumentacionit përkatës, kryetari i Komisionit dhe anëtarët nismëtarë për çështjet përkatëse mbështeten nga nëpunës civilë të strukturës përgjegjëse ose, rast pas rasti, nga punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas përcaktimit të nenit 17, të këtij vendimi.

Neni 11
Thirrja e mbledhjeve të Komisionit

1. Komisioni mblidhet sa herë është i nevojshëm shqyrtimi i një çështjeje ose rasti, por jo më pak se një herë në 3 (tre) muaj.

2. Mbledhja paraardhëse e Komisionit, përpara përfundimit të saj, diskuton dhe vendos, nëse e vlerëson të nevojshme, për rendin e ditës, ditën dhe kohën e zhvillimit të mbledhjes pasardhëse.

3. Nëse nuk është vendosur ndryshe nga mbledhja e mëparshme e Komisionit, mbi bazën e punës përgatitore dhe propozimeve të tjera të anëtarëve, Kryetari thërret mbledhjen dhe vendos rendin e ditës, datën dhe kohën e zhvillimit të saj.

4. Në rastet kur kërkohet me shkrim, nga të paktën 3 (tre) anëtarë të Komisionit, Kryetari është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Komisionit në datën, kohën dhe me rendin e ditës të përcaktuar nga anëtarët nismëtarë.

5. Kryetari ose, kur kërkohet me shkrim nga të paktën 3 (tre) anëtarë të Komisionit, mund të ftojë të marrë pjesë në mbledhje edhe një përfaqësues i Avokatit të Popullit që merr pjesë në cilësinë e vëzhguesit.

6. Në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore të kryetarit, veprimet përgatitore dhe thirrja e mbledhjes kryen nga zëvendëskryetari.

7. Në pamundësi objektive, papajtueshmëri, konflikt interesi ose pengesë ligjore si të kryetarit ashtu edhe të zëvendëskryetarit, mbledhja e Komisionit mund të thirret nga 3 (tre) anëtarë të tij, të cilët propozojnë edhe datën, kohën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Në këtë rast, puna përgatitore dhe mbledhja e Komisionit drejtohen nga anëtari i Komisionit më i vjetër në moshë.

Neni 12
Njoftimet për thirrjet e mbledhjes së Komisionit

1. Nëse nuk është vendosur ndryshe në mbledhjet e mëparshme të Komisionit, njoftimi për thirrjen e mbledhjes, i cili përmban rendin e ditës, datën, kohën e zhvillimit të mbledhjes, bëhet me shkrim, së paku 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara datës që caktohet për zhvillimin e saj.

2. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes, i cili përmban rendin e ditës, datën, kohën e zhvillimit të mbledhjes, i dërgohet të gjithë anëtarëve dhe Ministrisë së Drejtësisë.

3. Së bashku me njoftimin për thirrjen e mbledhjes, sipas rasteve dhe natyrës së çështjeve të rendit të ditës, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të komunikimit, anëtarëve të Komisionit u dërgohet edhe dokumentacioni përkatës i përgatitur nga personeli mbështetës.

4. Njoftimi i anëtarëve të Komisionit për zhvillimin e mbledhjes bëhet në rrugë shkresore, me anë të postës, korrierit, në rrugë elektronike apo të çdo mjeti tjetër të përshtatshëm komunikimi.

5. Me të njëjtat mjete komunikimi dhe brenda të njëjtave afate, njoftimi që përmban rendin e ditës, datën dhe kohën e zhvillimit të mbledhjes i bëhet edhe Avokatit të Popullit, në rastet kur vendoset për t'u ftuar një përfaqësues i tij, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 11, të këtij vendimi. Së bashku me njoftimin, Avokatit të Popullit i dërgohet dokumentacioni përkatës i përgatitur nga personeli mbështetës.

Neni 13
Procedura në rast të pengesës ligjore dhe konflikti të interesit

1. Anëtari i Komisionit, nëse ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, nuk merr pjesë në veprimtaritë dhe mbledhjet e Komisionit për çështjen ose rastin për të cilin ekzistojnë kushtet e konfliktit të interesit ose pengesës ligjore.

2. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara që trajtohen në veprimtaritë dhe mbledhjet e Komisionit, anëtari i Komisionit vihet në dijeni të rrethanave të tilla që, sipas ligjit, e vendosin atë vetë ose një anëtar tjetër, përpara njërit prej rasteve të konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, njofton menjëherë kryetarin e Komisionit dhe deklaron arsyet konkrete që sjellin pengesë për pjesëmarrjen në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e çështjes përkatëse.

Neni 14
Kuorumi i mbledhjes së Komisionit

1. Mbledhja e Komisionit zhvillohet kur janë të pranishëm jo më pak se 5 (pesë) anëtarë të tij dhe vendos me shumicën e votave.

2. Në rast se në ditën e caktuar nuk sigurohet kuorumi i nevojshëm, kryetari apo sipas rastit zëvendëskryetari ose anëtari që drejton mbledhjen, cakton një ditë tjetër sa më të afërt për zhvillimin e mbledhjes dhe njofton për këtë anëtarët e Komisionit që nuk ishin të pranishëm.

3. Në rast të mospjesëmarrjes pa shkaqe të justifikuara në veprimtaritë dhe mbledhjet e Komisionit, kryetari njofton menjëherë institucionet përkatëse që, sipas ligjit, kanë kompetencat për fillimin e procedimit disiplinor ndaj anëtarëve të Komisionit.

Neni 15
Punimet e mbledhjes së Komisionit

1. Kryetari deklaron fillimin e mbledhjes së Komisionit, verifikon prezencën e anëtarëve, duke informuar Komisionin për motivet e mungesës ose të pengesës së anëtarit të Komisionit që nuk është i pranishëm.

2. Kur verifikohet kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes, Kryetari paraqet çështjet e përcaktuara për shqyrtim në rendin e ditës. Komisioni merr vendime vetëm për çështjet të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje që nuk janë në rendin e ditës.

3. Pas miratimit të rendit të ditës, nëse anëtarët nuk ngrenë probleme të tjera të lidhura me ndonjërin prej rasteve të konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, Komisioni vijon me shqyrtimin e çështjeve.

4. Kryetari i Komisionit jep fjalën, drejton debatin dhe përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës. Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të marrin fjalën lidhur me secilën çështje të rendit të ditës.

5. Pas mbylljes së diskutimeve mes tyre, anëtarët e Komisionit shprehin qëndrimin dhe votojnë për zgjidhjen e çështjes. Kryetari i Komisionit shpreh qëndrimin dhe voton i fundit.

6. Komisioni vendos me shumicën e votave në prani të të paktën 5 (pesë) anëtarëve. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

7. Kryetari i Komisionit, përpara përfundimit të mbledhjes, propozon për diskutim ditën dhe kohën e zhvillimit të mbledhjes së ardhshme, si edhe çështjet e mundshme të rendit të ditës. Pasi Komisioni vendos për mënyrën se si do të procedohet, kryetari deklaron mbylljen e mbledhjes.

Neni 16
Dokumentimi i mbledhjes

1. Kryetari i Komisionit është përgjegjës për të siguruar që personeli mbështetës i vënë në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë të marrë të gjitha masat e nevojshme që çdo mbledhje e Komisionit të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes procesverbalit të mbledhjes.

2. Kryetari i Komisionit ngarkon një sekretar nga personeli mbështetës i Ministrisë së Drejtësisë për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes së Komisionit.

3. Në varësi edhe të natyrës së çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e Komisionit, procesverbali i mbledhjes përmban detyrimisht dhe në mënyrë të përmbledhur:

   a) datën dhe orën e fillimit e të mbarimit të mbledhjes;
   b) çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës;
   c) anëtarët e Komisionit të pranishëm;
   ç) përfaqësuesin e Avokatit të Popullit, kur ka qenë i pranishëm;
   d) veprimet procedurale të zhvilluara në mbledhjen e Komisionit;
   dh) përmbledhjen e diskutimeve të anëtarëve;
   e) rezultatet e votimit dhe dispozitivin e vendimeve të Komisionit për çështjet që ishin pjesë e rendit të ditës si dhe çdo qëndrim tjetër mbajtur gjatë punimeve të mbledhjes së Komisionit.

4. Procesverbali i dërgohet menjëherë për shqyrtim anëtarëve të Komisionit të pranishëm në mbledhje, të cilët, jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga dita e nesërme e marrjes në dijeni, duhet të njoftojnë kryetarin nëse kanë vërejtje për përmbajtjen e tij.

5. Procesverbali përfundimtar iu njoftohet menjëherë pjesëmarrësve në mbledhje. Ai shqyrtohet dhe miratohet si çështje e parë e rendit të ditës në mbledhjen pasardhëse të Komisionit, pas relatimit të kryetarit mbi kërkesat dhe korrigjimin e tij. Pas miratimit, procesverbali nënshkruhet nga anëtarët që

kanë marrë pjesë në mbledhje, si edhe nga personat e caktuar për mbajtjen e tij.

6. Procesverbali depozitohet për ruajte sipas legjislacionit në fuqi mbi arkivat, në sektorin e protokollit dhe arkivës të Ministrisë së Drejtësisë.

Neni 17
Personeli mbështetës dhe detyrat e tij

1. Komisioni ndihmohet në veprimtarinë e tij nga nëpunës civilë të strukturës përgjegjëse për monitorimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, në bashkëpunim me kryetarin e Komisionit. Periudha e angazhimit dhe numri i tyre caktohet sipas nevojave të përcaktuara nga Komisioni. Pasi caktohen, për këtë periudhë, këta punonjës kryejnë, sipas rastit dhe nevojës, me kohë të plotë apo të pjesshme, detyrat e ngarkuara nga Komisioni.

2. Përveç sa u kërkohet, rast pas rasti nga Komisioni ose kryetari, personeli mbështetës kryen veprime lidhur me hartimin e procesverbaleve të mbledhjes, hartimin e shkresave apo akteve të ndryshme të Komisionit, njoftimin e kryetarit të komisionit për çdo ankim ose njoftim të paraqitur për shqyrtim, dërgimin dhe ndjekjen e njoftimeve, veprime të tjera të sekretarisë, si edhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e mbledhjeve dhe veprimtarive të Komisionit.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18
Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit dhe mbledhja e parë e tij

1. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, organet e emërtesës fillojnë procedurën për caktimin e anëtarit, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin në fuqi për ekzekutimin e vendimeve penale dhe këtë vendim.

2. Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e fillimit të procedurës për caktimin e anëtarit, organi i emërtesës njofton ministrin e Drejtësisë për emrin dhe të dhënat e kontaktit të anëtarit që ka caktuar në Komision.

3. Ministri i Drejtësisë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e marrjes së njoftimit nga organi i emërtesës që ka caktuar i fundit anëtarin e tij, thërret mbledhjen e parë të Komisionit. Në rast se organet e emërtesës nuk kanë

njoftuar emrin e anëtarit të caktuar, pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ministri i Drejtësisë thërret mbledhjen e parë të Komisionit kur janë njoftuar caktimi i të paktën 5 (pesë) anëtarëve nga organet e emërtesës.

Neni 19
Shfuqizime

Vendimi nr.906, datë 19.12.2004, i Këshillit të Ministrave, "Për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Mbikëqyrjes të Ekzekutimit të Vendimeve Penale", shfuqizohet.

Neni 20
Organet zbatuese

Ngarkohen Presidenti i Republikës, kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Prokurori i Përgjithshëm, ministria përgjegjëse për arsimin, ministria përgjegjës për financat, ministria përgjegjës për shëndetësinë, ministria përgjegjës për drejtësinë dhe Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I DREJTËSISË

ETILDA GJONAJ

NR.PROT. 2857/1
DATË 19. 2. 2021

PRESIDENCËS
KUVENDIT
KRYEMINISTRISË
MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
DHOMËS SË AVOKATISË SË SHQIPËRISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE